


CHWB

Cultural
Heritage without Borders
KULTURARY UTĀN GRANSER

CHwB Kosovo Office
Report Series No. 22 / 2011



PLANI I KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT PËR ZONËN HISTORIKE TË PRIZRENIT, KOSOVË

Përparësitë dhe sfidat e implementimit

CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN FOR THE HISTORIC ZONE OF PRIZREN, KOSOVO

Advantages and challenges of implementation



Cultural
Heritage without Borders
KULTURARV UTAN GRÄNSER

Plani i Konservimit dhe zhvillimit për zonën historike
të Prizrenit, Kosovë
Përparësitë dhe sfidat e implementimit

Conservation and Development Plan for the historic
zone of Prizren, Kosovo
Advantages and challenges of implementation

6-7	Hyrje PRIZRENI s'ka kohë - duhet VEPRIM ...nga Sali Shoshi
8-9	Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit EKIPI REALIZUES I PROJEKTIT
10-11	HYRJE
12-13	PËRMBAJTJA DHE METODA E STUDIMIT
14-15	PËRSHKRIM I SHKURTËR I PRIZRENIT Prizreni dhe lokacioni i tij Karakteristikat natyrore dhe topografike të Prizrenit
16-19	HISTORIA E PRIZRENIT
20-21	KARAKTERISTIKAT E POPULLSISË SË KOSOVËS DHE PRIZRENIT
22-23	KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË PRIZRENIT
24-25	SHËRBIMET SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE EDUKIMI
26-27	VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT VIZIONI I PLANIFIKIMIT DHE QËLLIMI I PLANIT TË KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË PRIZRENIT
28-29	OBJEKTIVAT PLANIFIKUESE TË PLANIT TË KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË PRIZRENIT
30-33	STUDIMI DHE ANALIZAT E ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT Zona të ndërtuara dhe të pandërtuara Modeli i transportit në Zonën Historike të Prizrenit
34-35	ANALIZA E OBJEKTEVE DHE HAPËSIRAVE INDIVIDUALE Përdorimi i Pronës dhe Objektivit Gjendja e Objekteve Etazhiteti i objekteve Materialet Ndërtimore të Objekteve Shfrytëzimi i Objekteve Harmonia me karakterin Arkitektonik të Zonës Objektet Monumentale
56-77	ANALIZA E STRUKTURËS SOCIALE
78-87	EVALUIMI DHE VENDIMET PLANIFIKUESE NË PLANIN E KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT EVALUIMI I STUDIMIT DHE FORMULIMI I KRITEREVE PËR PROJEKTIM Planifikimi i Zonave duke u bazuar në Evaluimin e Studimit Revidimi i Planifikimit të Zonave me Studimet paraprake planifikuese Karakteristikat e Planifikimit të Zonave me Potencial, Probleme dhe Propozime Evaluimi i objekteve
88-89	PLANI PRELIMINAR I DIZAJNIT
90-105	VENDIMET E PLANIFIKIMIT Zonat e banimit Transporti Transporti publik Parqet Urbane Aktivitetet komerciale

Content

Introduction	6-7
PRIZREN has no time – ACTION is needed ...by Sali Shoshi	
Conservation and Development Plan for the historic zone of Prizren	8-9
PROJECT WORKING TEAM	
INTRODUCTION	10-11
CONTENT AND METHOD OF THE STUDY	12-13
BRIEF DEFINITION OF PRIZREN	14-15
Prizren and its location	
Natural and topographic characteristics of prizren	
HISTORY OF PRIZREN	16-19
POPULATION CHARACTERISTICS OF KOSOVO AND PRIZREN	20-21
ECONOMIC CHARACTERISTICS OF PRIZREN	22-23
SOCIAL SERVICES, HEALTH, AND EDUCATION	24-25
THE VISION, GOAL AND OBJECTIVES OF THE PRIZREN HISTORIC	26-27
AREA CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN	
PLANNING VISION, AND THE GOAL OF THE PRIZREN	
CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN	
PLANNING OBJECTIVES OF THE PRIZREN	28-29
CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN	
SURVEY AND ANALYSIS OF PRIZREN HISTORIC AREA	30-33
Built and Unbuilt-up Areas	
Transportation Pattern of Prizren Historic Area	
SURVEY OF INDIVIDUAL BUILDINGS AND SPACES	34-35
Use of Land and buildings	
Condition of buildings	
Building Story Heights	
Building Construction Materials	
Occupancy of Buildings	
Harmony with the Architectural Character of the Area	
Monumental Buildings	
SOCIAL STRUCTURE ANALYSIS	56-77
EVALUATION AND PLANNING DECISIONS OF PRIZREN	78-87
HISTORIC AREA CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN	
EVALUATION OF SURVEY AND FORMULATING CRITERIA FOR DESIGN	
Planning Zones According to Evaluation of the Survey	
Revision of Planning Zones with Previous Planning Study	
Main Characteristics of Planning Zones in the Headlines of Potential, Problems and Proposals	
Evaluation of buildings	
PRELIMINARY PLAN DESIGN -CONSERVATION AND DEVELOPMENT PLAN	88-89
PLANNING DECISIONS	90-105
Housing Areas	
Transportation	
Public transportation	
Urban Parks	
Commercial activities	

Përmbajtja

	Akomodimi
	Aktivitetet shoqërore dhe kulturore
	Arkitektura monumentale dhe civile
106	PROJEKTI
107	FAZAT E PLANIFIKIMIT
108-125	VENDIMET PLANIFIKUESE
126-159	UDHËZIMET E DIZAJNIT URBAN
	Udhëzimet e dizajnit urban për tetë sub-zonat
	Korniza e Normativave të Planit Urban të Prizrenit
	Intervenimet në Arkitekturën Qytetare
	Ndërtimet e reja dhe Aplikimet Plotësuese
160-161	REFERENCAT

Implementimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit

162-165	SFIDAT E MBROJTJES SË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT ...nga Jusuf Xhibo
	PLANI RREGULLUES URBAN PËR ZONËN HISTORIKE TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI
166-169	UDHËRRËFYES PËR ZHVILLIMIN LOKAL TË QYTETIT ...nga Shpresa Osmanollaj
170-177	ZBATIMI I PLANEVE NË VEPRIM ...nga UN Habitat zyra në Prizren
178	Ekipi realizues i publikimit

Content

Accommodation	
Social and Cultural activities	
Civil and monumental architecture	
PLAN DESIGN	106
PLANNING STAGES	107
PLANNING DECISIONS	108-125
URBAN DESIGN GUIDELINES	126-159
Design guidelines for eight sub-zones	
Framework of Prizren Urban Design Guidelines	
Intervention to civil architecture	
New Constructions and infill applications	
REFERENCES	160-161

Implementation of Conservation and Development Plan for Historic Zone of Prizren

CHALLENGES IN THE PROTECTION OF THE HISTORIC ZONE OF PRIZREN ...by Jusuf Xhibo	162-165
URBAN REGULATORY PLAN FOR THE HISTORIC ZONE OF PRIZREN AS A	
PATTERN FOR LOCAL DEVELOPEMENT OF THE TOWN ...by Shpresa Osmanollaj	166-169
IMPLEMENTATION OF PLANS INTO ACTIONS ...by UN Habitat Prizren office	170-177

Publication Team	178
-------------------------------	-----

PRIZRENI s'ka kohë - duhet VEPRIM

Prizreni ka një pejzash mahnitës të formësuar nga Zoti, që i fali Lumbardhin dhe gjithë natyrën përreth, dhe jetën që i dha Njeriu. Kjo shkrijë Zot-Njeri në Prizren është e lashtë qysh nga antikiteti. Njeriut, si çdo qenie tjetër e gjallë, ia ka ënda vendet me ujë, tokë pjellore, me klimë të përshtatshme. E, Prizreni i ka të gjitha këto: klimë pothuajse mesdhetare, ujë, prroska, kroje, shatërvanë në çdo rrugicë; ndërsa sa të dalësh pak nga Rahoveci - toka pjellore të bollshme, rrush e verë sa të duash.

Njeriu, në Prizren, i bëri vetes strehë. Ndërtoi shtëpi, rrugë, ura, kala. Ai aty foli me Zotin në gjuhë të ndryshme - në qiell të hapur, në kishë, xhami e teqe.

Ata ndërtuan edhe pazare e namazgjahë. Në to zanatlinjë tregtonin me Shkupin, Shkodrën, Selanikun, e Stambollin. Qebapë, e më pastaj një kafe shpie, (ne ballkanasit nuk pajtohem asnjëherë se kafe e kujt është) me një bakllava, më bën të ndihem si në Prizren. Grupi "Gjurmët" i këndojnë trenit për Prizren, një uverturë për rininë dhe dashurinë që bashkëdyzohet me sharmin e Prizrenit. Tash së fundi, Prizreni ka edhe autostradë që t'çon në Tiranë. Edhe pse tash për tash s'ka logo të qytetit, ai e ka festivalin ma t'mirë në këto vise – Dokufestin.

E bëra këtë hyrje për ta theksuar edhe njëherë rëndësinë e "kryeqytetit kulturor" të Kosovës, për të cilin njerëzit flasin me shumë krenari e dashuri, herë herë me përbuzje e nganjëherë edhe me ironi e me popullizëm. Por, përtej retorikës, Prizreni ka nevojë për kujdes; ka nevojë për një dorë që e ruan, e mbron, që si të tillë e bën atë edhe më të afërt e më të hapur për njerëzit, e të tillë ta përcjellë tek gjeneratat tjera!

Që nga viti 2005, Trashëgimia Kulturore pa Kufij, është munduar që sado pak të ofroj këtë dorë kujdesi. Përmes bashkëpunimit me institucione qendrore, lokale dhe me akterë tjerë civil dhe profesional, kemi realizuar një numër të madh të projekteve të natyrave të ndryshme, filluar nga konservimet dhe restaurimet e ndërtesave historike, trajnime të specializuara me ekspertë dhe studentë, punë me komunitetin e deri në trajtimin e hapësirës urbane që njihet si Zona e Historike e Prizrenit. Me bashkëpunimin e specialistëve nga Italia, Turqia, Suedia dhe Kosova është arritur që të hartohet Plani i Konservimit dhe i Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, që është një Plan Master i cili iu shërben autoriteteve në menaxhimin e aspekteve të konservimit dhe zhvillimeve urbane të kësaj pjese. Me fjalë tjera, ky Plan, që është i bazuar në metodologji të avancuar ndërkombëtare, udhëzon se si të ruhet indi urban tradicional i Prizrenit edhe në rastet kur qyteti zhvillohet dhe rritet. Autoritetet lokale dhe qendrore sot e kanë shumë më të lehtë që t'u japin përgjigje sfidave të menaxhimit urban në harmoni me karakterin tradicional të qytetit të Prizrenit.

Situata në terren nuk duket të jetë shumë premtuese. Ndërtesat e reja mbijnë si kërpudhat pas shiut dhe çdo ditë humbet nga një pjesë mozaiku e panoramës së këtij qyteti. Është koha e fundit për VEPRIM. Asnjë çast nuk duhet humbur që ta shpëtojmë Prizrenin. Shpresojmë që përmes këtij dokumenti kemi krijuar mundësi që Prizreni përfundimisht të vendoset në parametrat e një qyteti funksional me zhvillim të qëndrueshëm, ku në qendër të këtij zhvillimi është njeriu dhe kultura e tij e trashëguar, e ku kjo kulturë komunikon me botën si pjesë e pandashme e saj.

Sali Shoshi

Drejtor i CHwB zyra në Kosovë

Dhjetor 2011

Introduction

PRIZREN has no time – ACTION is needed

Prizren has a stunning landscape shaped by God – who bestowed it with Lumbardhi River and all the revolving scenery – and awarded with life by a Man. This God-Man blending in Prizren rolls up from the early antiquity. Man, like any other living being, delights places with water, fertile land and suitable climate. Prizren has everything of that: almost Mediterranean climate, water, watercourses, springs, fountains in every alley; and when going forth to Rahovec - abundant fertile lands, grapes and wine as much as you want.

Man shaped himself a heaven in Prizren. He built houses, roads, bridges and a fortress. There he spoke to God in different languages in the open, in church, mosque and tekke.

They also built bazaars and namazgahs. Within those, craftsmen traded with Shkup/Skopje, Shkodra, Selanik/Thessaloniki and Istanbul. Kebabs, followed then with a home flavored coffee (in the Balkans we are still at odds whose coffee it is) and a baklava, makes one feel just like in Prizren. The rock band “Gjurmët” sing to the train for Prizren, an overture to the youth and love that liquefies with the charm of Prizren. Just recently, Prizren got a motorway, bringing you to Tirana. Although the city has been deprived of its own logo, it accommodates the most paramount festival in these parts – Dokufest.

I brought such entry in highlighting once again the importance of the “cultural capital” of Kosovo, for which many people talk with pride and affection, at times with contempt and sometimes even with mockery and populism. But, beyond rhetoric, Prizren needs attention, a hand of care in preserving, protecting and making it much closer and more open to people, and as such, passing it over to other generations!

Since 2005 Cultural Heritage without Borders sought in providing a bit of this attention. Owing to the cooperation with central and local institutions and other public and professional stakeholders, we have implemented a large number of projects of different types; ranging from the conservation and restoration of historic buildings, specialized trainings with the experts and students, work with the community and up to the treatment of urban area known as the Historic Zone of Prizren. With the cooperation of specialists from Italy, Turkey, Sweden and Kosovo we've achieved in drafting of the Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren, which is a Master Plan serving the authorities in the viewpoint of the management in conservation and urban development of this centre. Put in other words, this Plan, established on international advanced methodologies, guides on the ways of preservation of Prizren's traditional urban pattern, yet in cases of the development and the growth of the city. It is much easier for local and central authorities today in providing answers to the challenges of urban management, in compliance with the traditional character of the town of Prizren.

Situation on the ground does not seem very promising. New buildings pop up just as mushrooms after the rain, and a part of the city's landscape patchwork is lost every day. This is a last call for ACTION. No moment should be missed for the salvage of Prizren. We do hope that with this document we have created the opportunity for Prizren to eventually be placed in the parameters of a functional city with a sustainable development, where the center of this development is the individual and his inherited culture – culture which commutes with the world as its inseparable part.

Sali Shoshi
Director of CHwB office in Kosovo
December 2011

Conservation and Development Plan for the historic zone of Prizren

EKIPI REALIZUES I PROJEKTIT / PROJECT WORKING TEAM

KORDINATOR I PROJEKTIT / PROJECT COORDINATOR

Prof.Dr. Nuran ZEREN GÜLERSOY

(Arkitekt / Planer Urban) - Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i Planifikimit Urban dhe Regjional

(Architect / Urban Planner) - ITU Faculty of Architecture / Department of Urban and Regional Planning

STAFI I PROJEKTIT / PROJECT STAFF

Dr. Engin EYÜBOGLU,

(Planer Urban) - Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i Planifikimit Urban dhe Regjional

(Urban Planner) - ITU Faculty of Architecture / Department of Urban and Regional Planning

Kerem KORAMAZ

(Urban Planner) - Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i Planifikimit Urban dhe Regjional

(Urban Planner) - ITU Faculty of Architecture / Department of Urban and Regional Planning

STAFI TEKNIK / TECHNICAL STAFF

Pinar ABACILAR,

(Arkitekt) - Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Qendra për Planifikim dhe Hulumtim Mjedisor

(Architect) - ITU Environmental and Planning Research Center

KONSULTANT I PROJEKTIT

Prof.Dr. Zeynep AHUNBAY

(Arkitekt) - Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i Arkitekturës / Divizioni i Restaurimit

(Architect) - ITU Faculty of Architecture / Department of Architecture / Division of Restoration

Shend KABASHI (Planer Lokal/ Local Planner)

Në muajin Maj të vitit 2006, Komuna e Prizrenit së bashku me CHwB nënshkruan “Memorandumin e Mirëkuptimit për Implementimin e Programit të Rehabilitimit të Zonës Historike të Prizrenit”. Ky Program përfshin edhe komponente tjera që janë të rëndësishme për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës historike.

“Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit” është njëri nga hapat konkrete drejt planifikimit dhe ruajtjes së kësaj zone historike. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në zhvillimin urban është me rëndësi të madhe në mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave historike në qendrat urbane. Kjo është njëra nga iniciativat e para të komunave në Kosovë në hartimin e Planit të Konservimit të Zonave Historike.

Studimi i “Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit” është përgatitur duke u bazuar në konceptin e ndryshimit të konservimit në drejtim të kuptimit të revitalizimit, koncept ky që vë në pah çështjet të cilat kanë të bëjnë me rikthimin e vlerave ekonomike të karakterit urban tradicional dhe karakterit arkitektonik me përcaktimin e intervenimeve fizike të nevojshme për përdorimin dhe ripërdorimin duke pasur parasysh relacionet socio-ekonomike urbane.

Evaluimi i ambientit historik të Prizrenit dhe vendimet zhvillimore në kuadër të procesit të planifikimit kërkon qasje integruese të konservimit, planifikimit dhe strategji të dizajnit urban bazuar në dokumentacion gjithëpërfshirës. Hulmimet dhe studimet konservuese të kaluara në lidhje me zonën historike janë hulumtuar dhe evaluar gjatë këtij studimi. “Draft Normativat për Ruajtjen e Zonës Historike të Prizrenit” dhe “Plani Pilot për Mbrojtje dhe Zhvillim të Zonës Historike”, të cilat janë hartuar nga koordinimi i Politeknikut të Torinos përkrahur nga stafi i zyres së CHwB në Kosovë janë evaluar dhe përdorur në mënyrë të veçantë në fazën e hulumtimeve dhe analizave (CHwB dhe Politekniku i Torinos, 2005).

Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit ka për qëllim të formulon determinantet që përmbajnë një zhvillim të duhur dhe bashkëkohor të cilësisë mjedisore të Zonës Historike të Prizrenit, me ruajtjen e vlerave historike, arkitekturale dhe funksionale; si dhe përmirësimin e planeve të zhvillimit përmes këtyre vendimeve.



Silueta Urbane e Nënkalasë në fillim të shekullit 20-të
Nënkalaja Urban Silhouette in the beginning of the 20th Century

INTRODUCTION

In May 2006, Prizren Municipality together with CHWB signed a “Memorandum of Understanding for Implementation of Rehabilitation Programme for the Historic Zone of Prizren”. This Programme includes different components that are important for the protection and development of the historic zone.

“Prizren Historic Area Conservation and Development Plan” is one of the first concrete steps towards planning of protection for this historic zone. Inclusion of cultural heritage in urban development planning is of essential importance in protection and development of the historic zones in urban centers. This is one of the first initiatives in Kosovo municipalities on drafting a Conservation Plan of a Historic zone.

Study of “Prizren Historic Area Conservation and Development Plan” is prepared within the concept of conservation changing towards an understanding of revitalization which brings the issue of regaining economic value of traditional urban and architectural character with the determination of spatial interventions required for use and reuse considering the socio-economic urban relations.

Evaluation of Prizren historic environment and development decisions within planning process needs integrated approach of conservation, planning and urban design strategies based on a comprehensive documentary. Previous research and conservation studies related to the historic zone are also investigated and evaluated at the beginning of this study. “Draft Prizren Preservation Guidelines for the Historical Area” and “Pilot Preservation and Development Plan for the Historical Area”, which were held by the coordination of Polytechnic of Torino and supported by Kosovo CHWB local office members, have been evaluated and used especially on survey and analysis stages (CHWB and Politecnico di Torino, 2005) of this project.

Prizren Historic Area Conservation and Development Plan is aimed to formulate general planning determinants that maintain the appropriate and contemporary development of the environmental fabric of Prizren Historic Area while preserving its historical, architectural and functional values; and to improve detailed development plans beyond these decisions.



Pamja e Urës së vjetër të gurit në fillim të shekullit 20-të
View of the old Stone bridge in the beginning of the 20th Century

PËRMBAJTJA DHE METODA E STUDIMIT

Në këtë projekt, Zona e Parë e Mbrojtjes e Zonës Historike të Prizrenit është trajtuar si zonë studimi. Studimi përmban një gjendje të shkurtër mbi arealin historik dhe historinë e Prizrenit; qëllimet dhe objektivat e aktiviteteve për konservim dhe zhvillim. Studimi gjithashtu përfshin analiza të zonës lidhur me transportin në zonën e planifikuar, shfrytëzimin e tokës dhe shfrytëzimin e ndërtesave në katin përdhe dhe katin e parë, gjendjen e ndërtesave, etazhitetin e ndërtesave, materialet ndërtimore, pronat, zotërimin e ndërtesave, përshtatshmëria e ndërtesave me strukturën fizike të zonës dhe rrethinës së saj. Studimi gjithashtu përbëhet nga studimet sociale me qëllim që të shfaqin aspektet demografike, sociale dhe kulturore të banorëve të ndërtesave që gjenden në listë dhe jashtë saj.


Vendimet përkitazi me planifikim dhe konservim janë zhvilluar duke marrë në konsiderim studimet e niveleve më të larta (Forumi Europa Nostra dhe Takimet përgaditore 2006; Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe Nixha Partneres, 2003), hulumtimet dhe studimet e inventarizimit për mbrojtje të monumenteve dhe zonave (Koçbashliu, 2006; Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve IMM dhe CHwB 2006; Rexha, 2004)

Vlerësimi i studimit në dimensionin e punës në terren dhe shpjegimit të vendimeve mbi konservim që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës dhe të ndërtesave, cilësinë urbane dhe të transportit, pronat e listuara dhe të pa listuara, zhvillimit socio-kulturor duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e thëna në studim. Pas evaluimit të gjithë zonës konservuese, zona historike është e ndarë në nën-zona dhe kushtet egzistuese dhe pritet për të ardhmen u determinuan në propozimet hapësinore, shoqërore dhe politike që janë zhvilluar për të ardhmen e Prizrenit.

Në këtë aspekt, vendimet lidhur me transportin, vendimet lidhur me shfrytëzimin e tokës, vendimet lidhur me intervenimet fizike në objektet e listuara, vendimet lidhur me strukturat tjera që nuk duhet të konservohen dhe vendimet ristrukturuese lidhur me parcelat e zbrazëta janë paraqitur në plan. Në fazën e fundit të planit studiuës janë zhvilluar poashtu edhe Udhëzuesit e Dizajnit të Planit të Konservimit të Prizrenit.



CONTENT AND METHOD OF THE STUDY



In this project, First Conservation Zone of Prizren Historic Site has been given as a study area. The study contains a brief account of the Prizren Historic Site; its history; the vision, goals and objectives of the conservation and development activities. The study also includes the area analysis as related to transportation in the planning area, land use and building use of ground and upper floors, building conditions, storey heights, construction materials, land ownership, building occupancy, building compatibility with the physical structure of the area, listed lots and buildings. In addition to the physical analysis of the buildings and their surroundings, the study also comprises social studies aimed at displaying the demographic, social and cultural aspects of the residents of the listed and non-listed buildings.

Planning and conservation decisions of the Prizren Historic Zone have been developed considering the existing upper scale planning studies (Europa Nostra Forum and Preparatory Meetings 2006; Municipal Assembly of Prizren and Nixha Partners, 2003), and previous studies about protection of monuments and sites (Koçbashliu and others, 2006; Institute for the Protection of Monuments, IPM and CHwB, 2006; Rexha, 2004).

The evaluation of the study in dimensions of fieldwork and an explanation of conservation decisions related to land use and buildings, transportation and urban fabric, listed and non-listed properties and socio-cultural development considering the vision, goal and objectives stated in the study. After the evaluation of the whole conservation area, the area was divided into sub-areas and the existing conditions and future expectations were determined and spatial, social and political proposals were developed for the future of Prizren.

In this regard, decisions related to transportation, decisions related to land use, decisions related to physical intervention in listed buildings, decisions related to other structures that need not be conserved, and re-structuring decisions related to vacant lots have been shown on the plan. At the last stage of planning study, in the urban design level, Prizren Conservation Plan Design Guideline has been developed.

PËRSHKRIM I SHKURTËR I PRIZRENIT PRIZRENI DHE LOKACIONI I TIJ

Republika e Kosovës është një shtet i vogël në qendër të Gadishullit Ballkanik. Kosova kufizohet me Maqedoninë (IRJM), Shqipërinë, Serbinë dhe Malin e Zi. Ka sipërfaqe 10 877 km². Bazuar në Rezolutën 1244 të 12/6/1999 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kosova ka qenë territor i administruar nga Administrata Civile e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ka qenë e prezantuar nga Sekretari Gjeneral i Kombeve të Bashkuara, anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të KB më 26 Mars 2007. Në Deklaratën e saj të Pavarësisë më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shprehi përkushtimin e tij për implementim të plotë të marrëveshjes. Provizionet e Marrëveshjes janë përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 9 Prill 2008.

Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina. Kosova është e ndarë në 7 regjione / sektorë dhe 30 njësi administrative (komuna). Këta sektorë janë Ferizaj, Gjakova, Gjilan, Mitrovica, Peja, Prishtina, Prizren. Komunitat janë: 1. Deçan, 2. Dragash, 3. Ferizaj, 4. Fushë - Kosovë, 5. Glogoc, 6. Gjakova, 7. Gjilan, 8. Istog, 9. Kaçanik, 10. Kamenica, 11. Klina, 12. Leposaviq, 13. Lipjan, 14. Malisheva, 15. Mitrovica, 16. Novobërda, 17. Obiliq, 18. Peja, 19. Podujeva, 20. Prishtina, 21. Prizren, 22. Rahovec, 23. Skënderaj, 24. Suhareka, 25. Shtërpce, 26. Shtime, 27. Viti, 28. Vushtrri, 29. Zveçan dhe 30. Zubin – Potok (Komuna e Prizrenit, 2007).

Komuna e Prizrenit gjendet në Jug të Kosovës dhe përmban sipërfaqe prej 640 km² (63,871.68 ha); kjo vlerë përmban 5.94 % të territorit të përgjithshëm të Kosovës. Prizreni në perëndim ndanë kufirin me Shqipërinë, në jug me Komunën e Dragashit, në juglindje me Maqedoninë, në lindje me Komunën e Shtërpçës, në verilindje me Komunën e Suharekës, në veri me Komunën e Rahovecit dhe në veriperëndim me Komunën e Gjakovës. Qendra e Komunës së Prizrenit është qyteti i Prizrenit (Komuna e Prizrenit, 2002). Largësia nga Prizreni në Prishtinë është 77 km, në Suhareke është 18 km, në Rahovec 32 km, në Malisheve është 45 km dhe Dragash është 37 km.



KARAKTERISTIKAT NATYRORE DHE TOPOGRAFIKE TË PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit gjendet në lartësinë mbidetare 412 - 500 m. Është e rrethuar me Malet e Sharrit, të cilët pikën më të lartë e arrijnë 2,748 m. Komuna e Prizrenit ka një rrjet të pasur dhe të ngjeshur të lumenjve. Lumenjtë rrjedhin drejtë Drinit të Bardhë dhe Detit Adriatik. Lumenjtë të cilët rrjedhin nga Mali i Sharrit janë shumë të shpejtë dhe të thellë, dhe kanë çarje të ngushta, të cilat shpesh formësojnë kantonet. Këta lumenj janë në gjendje ta mbajnë nivelin e ujit për shkak të shkrirjes së borës nga Mali i Sharrit. Rrjedha mesatare e ujit të lumit është 56 m³/sekondë dhe rezervuari i tij ka sipërfaqe totale prej 18,592 km² (Komuna e Prizrenit; 2002). Në Komunën e Prizrenit dominon klima kontinentale për shkak të maleve të afërta të cilat e rrethojnë komunën. Klima Mediterane gjithashtu depërton në Komunën e Prizrenit nga rrymat e Adriatikut që vijnë nëpërmjet kanjonit të Drinit të Bardhë. Kjo klimë ndihmon në kultivimin e rrushit si dhe pemëve dhe perimeve të tjera. Temperatura vjetore mesatare në Komunën e Prizrenit është 12.5 OC, me temperaturën më të ulët 1.3 OC gjatë muajit Janar dhe me temperaturë më të lartë 23.2 OC gjatë muajit Korrik (Komuna e Prizrenit; 2002).

BRIEF DEFINITION OF PRIZREN

PRIZREN AND ITS LOCATION

Republic of Kosovo is a small country in the center of the Balkan Peninsula. Kosovo borders Macedonia (FYROM), Albania, Serbia and Montenegro. Its area is 10 877 sq. km. Based on Resolution of the UN Security Council no. 1244 of 12/6/1999, Kosovo was a territory administered by the United Nations Interim Civil Administration. The Comprehensive Proposal for a Status Settlement for Kosovo was presented by the Secretary-General of the United Nations to the UN Security Council members on 26 March 2007. In its Declaration of Independence on 17 February 2008, the Assembly of Kosovo committed itself fully to implementation of the settlement. The provisions of the Settlement are enshrined in the Constitution of the Republic of Kosovo, adopted by the Kosovo assembly on 9 April 2008.

The capital of Kosovo is Prishtina. It is divided into 7 Sectors and 30 administrative units (municipalities). These sectors are Ferizaj, Gjakova, Gjiilan, Mitrovica, Peja, Prishtina, and Prizren. The municipalities are 1. Deçan, 2. Dragash, 3. Ferizaj, 4. Fushë - Kosovo, 5. Glogoc, 6. Gjakova, 7. Gjiilan, 8. Istog, 9. Kaçanik, 10. Kamenica, 11. Klina, 12. Leposaviq, 13. Lipjan, 14. Malisheva, 15. Mitrovica, 16. Novobërda, 17. Obiliq, 18. Peja, 19. Podujeva, 20. Prishtina, 21. Prizren, 22. Rahovec, 23. Skënderaj, 24. Suhareka, 25. Shtërpce, 26. Shtime, 27. Viti, 28. Vushtrri, 29. Zveçan and 30. Zubin – Potok (Prizren Municipality, 2007).

The Municipality of Prizren is located in southern Kosovo. It consists of an area of 640 km² (63,871.68 ha); this makes up 5.94 % of the total country in Kosovo. Prizren shares borders with Albania in the west, the Municipality of Dragash in the south, FYR of Macedonia in the southeast, the Municipality of Shtërpce in the east, the Municipality of Suhareke in the north-east, the Municipality of Rahovec in the north and the Municipality of Gjakove in the north-west. The centre of the Municipality of Prizren is Prizren town (Municipality of Prizren; 2002). The distance from Prizren town to Prishtina is 77 km, to Suhareke is 18 km, to Rahovec is 32 km, and to Malisheve is 45 km to Dragash is 37 km.



NATURAL AND TOPOGRAPHIC CHARACTERISTICS OF PRIZREN

The Municipality of Prizren has an altitude of 412 - 500 m. It is surrounded by the Sharr Mountains, which reach 2,748 m at their highest point. There is an abundant and dense river network within the Municipality of Prizren. The rivers all flow towards the Drini Bardhe River and into the Adriatic Sea. The rivers, which flow from the Sharr Mountains, are very fast and deep, and have narrow gaps, which often form canyons. These rivers are able to maintain their water levels due to the melting snow from the Sharr Mountains. The average water flow of the river is 56 m³/second and its reservoir has a total area of 18,592 km² (Municipality of Prizren; 2002). The Municipality of Prizren predominantly has a continental climate, which results from its vicinity to the mountains that surround the municipality. The Mediterranean climate also reaches the Municipality of Prizren due to the warm Adriatic draught that comes through the Drini i Bardhe River canyon. The Mediterranean climate helps with the cultivation of grapes, as well as other fruits and vegetables. The average annual temperature in the Municipality of Prizren is 12.5 °C, with a low temperature of 1.30°C in January and a high temperature of 23.20°C in July (Municipality of Prizren) 2002).

Prizreni, Theranda antike, gjatë periudhave të ndryshme historike shfaqet si një qendër e madhe ekonomiko-kulturore. E ndeshim me emra të ndryshëm. Sipas dokumenteve latine: Prisen, Prisennum, Presarin, Prisarano, Priseno, Prisor, Pristren, Prisarini, Jorsaim, etj. ; Bizantinët e quajtën Prisdriana, Prezren, Prizorian; në dokumente Osmane e ndeshim me emrat: Tarzerin, Perserin, Prizerin, Zerim, etj.; në dokumente sllave ndërkaq e ndeshim me emrat: Prizren, Prezren, Prizrin, Prizdren, Prezdrin, etj.

Trashëgimia Kulturore e Prizrenit reflekton historinë e mrekullueshme të qytetit me një kulturë të shtresuar gjatë shekujve deri në ditët e sotme. Duke zotëruar një pozitë të mirë gjeografike dhe gjeopolitike, Prizreni gjithmonë është gjendur në udhëkryq të kulturave të mëdha, si dhe të kulturave etnike, të cilat kanë jetuar njëra pranë tjetrës, si: dardano-iliro-shqiptare, romake, bizantine, serbe, turko-osmane, etj. Në qytetin e Prizrenit gjatë shekujve flitëshin disa gjuhë zyrtare.

Prizreni në antikitet njihet me emrin Theranda, dhe u zhvillua historikisht në rrugët e tregtisë së Ballkanit. Gjatë periudhës së Bizantit qyteti është quajtur Prisdriana. Në vitin 1018/1019 sipas Kartës së perandorit Bizantin Bazili II, Prizreni përmendet si Peshkopatë nën juridiksionin e Kryepeshkopatës së Ohrit. Në vitin 1072 nën udhëheqjen e George Voiteh-ut u zhvillua kryengritja e popujve të Ballkanit kundër pushtetit të perandorit Bizantin Mihali VII Duka, kryengritje kjo që u shua në vitin 1073. Menjëherë pas Kryqëzatës së Katërt, më 1204 Prizrenin e sundonin bullgarët. Rreth viteve 1214/1216 Stefan Prvovençani (i Kurorëzuar i Parë) e pushtoi Prizrenin, qytet ky që më pastaj, kohë pas kohe hyri nën bullgarët. Gjatë kësaj periudhe, qyteti ishte i mbrojtur nga një fortifikatë dhe disa fortifikata në rrethe të saj. Prizreni ishte qytet i tregëtisë së lirë, rezidencë e ipeshkvit katolik dhe peshkopit bizantin, bullgar dhe serb, si dhe ishte qendër e artit dhe e kulturës.

Kulmin e zhvillimit, Prizreni e arriti gjatë shekullit XIV. Në këtë kohë Prizreni kishte marrë pamje tipike të qyteteve perëndimore mesjetare: *civitas* (qendër administrative e ekonomike) dhe *castrum* apo *castellum* (qytet kala). Sipas përshkrimeve që i bënin udhëpërshkruesit, i ngjante shumë Raguzës (Dubrovnikut). Në të vërtetë, Prizreni gjatë gjysmës së parë të shekullit XIV, ishte qendër e madhe e kolonistëve raguzanë. Për qëllime të mbrojtjes së interesave, tregtarët raguzanë që vepronin në Prizren, kërkuan që të emërohej një konsull në këtë qytet. Sipas vendimit të Këshillit të Madh Raguzan të datës 8.III.1332, u ngritë konsullata raguzane në Prizren (*quod eius mansio sit in Prisen*). Data e sipërme shënon edhe fillimet e jetës konsullare në Kosovë. Ndërkaq, Prizreni zotëronte eksteritorialitet gjyqësor. Një përvojë e këtillë u përcoll edhe në qytete të tjera të Kosovës, si, në Novobërdë, Trepçë, Prishtinë, Pejë dhe Janjevë. Paralelisht konsullatës në Prizren, Raguzanët ngritën edhe disa institucione të tjera, si, doganën, farkëtoren për prerjen e monedhave, kisha dhe spitale. Në këtë qytet është farkuar monedha me mbishkrim "Prisen".



Arasta dhe rrethina e saj në fillim të shekullit 20-të
Arasta and its Surrounding in the Beginning of the 20th Century



Arasta dhe rrethina e saj, 2006
Arasta and its Surrounding in 2006

HISTORY OF PRIZREN

During different historical periods, Prizren, or ancient Theranda, appears as a large economic-cultural centre. We come across it with various names. According to Latin documents: Prisen, Prisenum, Presarin, Prisarano, Prisreno, Prisori, Pristren, Prisarini, Jorsaim, etc.; the Byzantines called it Prisdriana, Prezren, Prizorian; in Ottoman documents it is referred to with the names: Tarzerin, Perserin, Prizerin, Zerin, etc.; meanwhile in slav documents we come across it with the names: Prizren, Prezren, Prizrin, Prizdren, Prezdrin, etc.

The cultural heritage of Prizren reflects the wonderful history of a town with a culture that stretches throughout the centuries up to the present day. By commanding a good geographical and geo-political position, Prizren was always situated at the crossroads of great cultures and also ethnic cultures, which lived next to each other, such as: Dardanian-Illyrian-Albanian, Roman, Byzantine, Serb, Turkish-Ottoman, etc. In the town of Prizren various official languages were spoken during the centuries.

In antiquity, Prizren was known as Theranda, and it developed historically on the trade routes of the Balkans. During the Byzantine period, the town was called Prisdriana. In the year 1018/1019 according to the Charter of the Byzantine Emperor Basil II, Prizren is mentioned as a Bishopric under the jurisdiction of the Archbishop of Ohrid. In 1072, the Balkan peoples rose up under the leadership of George Voiteh, against the regime of the Byzantine Emperor Michael VII Doukas, a rising which was eliminated in 1073. Immediately after the Fourth Crusade of 1204, Prizren was ruled by the Bulgarians. Between the years 1214-1216, Prizren was conquered by Stefan Prvovenčani (the first crowned), but the town was later gradually taken over by the Bulgarians. During this period, the town was protected by fortifications as well as by other fortifications in its surroundings. Prizren was a town of free trade, the residence of the Catholic Bishop and the Byzantine, Bulgar and Serb Bishops, as well as being a centre of art and culture.

Prizren reached the culmination of its development in the 14th century. At this time, Prizren looked like a typical western medieval town: *civitas* (administrative and economic centre) and *castrum* or *castellum* (castle town). According to the descriptions given by travel writers, it was very similar to Ragusa (Dubrovnik). Actually, during the first half of the 14th century, Prizren was a large centre of Ragusan colonists. In order to protect their interests, Ragusan merchants who were operating in Prizren, demanded the appointment of a Consul in the town. According to the decision of the Grand Ragusan Council, dated 8.III.1332, a Ragusan Consulate was established in Prizren (*quod eius mansio sit in Prisen*). This date onwards marks the start of Consular life in Kosovo. In the meantime, Prizren possessed legal extraterritoriality. Other towns in Kosovo were having similar experiences, such as Novobërda, Trepça, Prishtina, Peja and Janjeva. As well as the Consulate in Prizren, the Ragusans also established other institutions such as customs, a mint for the cutting of coins, a church and a hospital. In the town, coins with the words "Prisren" were minted.



Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe rrethina në fillimin e shekullit 20
Gazi Mehmet Pasha Bath and Its Surrounding in the 20th Century



Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe rrethina, 2006
Gazi Mehmet Pasha Bath and Its Surrounding, 2006

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV qyteti filloi të dobësohej për shkak të konflikteve dhe përçarjeve politike. Atëbotë, pas vdekjes së perandorit Dushan (më 1355), qyteti sundohej nga mbreti serb Vukashin (1360-1371), më pastaj pas vdekjes së Vukashinit më 1371, Prizreni u sundua nga princërit arbërorë të familjeve Balshaj dhe Kastrioti. Gjatë gjithë mesjetës në Prizren dhe rrethe janë ngritur monumente të njohura të kultit Romano-Katolik (*Sancta Maria de Prisen* dhe *Sanctus Petrus supra Prisen*), dhe monumente të kultit Ortodoks Bizantin dhe Serb (Kisha e Zojës Prene-Bogorodica Ljeviška, dhe Manastiri i Shenjtorëve Mihal e Gabriel-Sveti Arhandjeli afër Prizrenit, etj.).

Ka të ngjarë se Prizreni disa herë kishte rënë nën osmanët. Mirëpo, më 1459, qyteti ra përfundimisht nën administrimin e Perandorisë Osmane ku dhe lulëzoi përsëri. Në shekullin XVI u ndërtuan monumente kulti të mrekullueshme Osmane si Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Hamami i Gazi Mehmet Pashës, dhe Xhamia e Sinan Pashës. Në atë kohë Prizreni u bë pjesë e provincës Osmane të Rumelisë. Shquhej për qytet tregtar me prosperitet, duke përfituar nga pozita gjeografike dhe rrugëve tregtare në veri-jug dhe lindje-perëndim që lidheshin mirë me gjithë Perandorinë Osmane. Prizreni u bë qytet më i madh i administratës osmane në Kosovë. Qyteti u pushtua përsëri në fund të shekullit XVII nga Austriakët dhe forcat aleate të tyre. Mirëpo, osmanët shumë shpejt e vunë nën kontroll përsëri.

Prizreni ishte qendër kulturore dhe intelektuale e Kosovës gjatë periudhës Osmane. Ishte e dominuar nga popullata e saj Myslimane, që e përbënin mbi 70% të popullsisë së saj në vitin 1857. Më 1878, në kohën e Lidhjes së Prizrenit, qyteti u bë qendra më e madhe kulturore e shqiptarëve dhe kryeqytet i koordinimit të politikës dhe kulturës së shqiptarëve jo vetëm të Kosovës.

Në shekullin XX qyteti përfundoi një periudhë intensive të ndërimeve rapide posaçërisht në zonat tregtare. Kah fundi i vitit 1918 kur u formua Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, Prizreni u ripushtua dhe hyri nën mbretërinë e porsathemeluar, e cila nga viti 1929 është quajtur Mbretëria e Jugosllavisë. Me decenie të tëra pas instalimit të qeverisjes së egër serbe në Prizren, qyteti në fjalë u bë njëra ndër qendrat e nacionalizmit Shqiptar në luftë për pavarësi.

Prizreni dhe rrethët e saj ishin të prekur në mënyrë të rëndë nga lufta në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Pas përfundimit të luftës në Qershor të vitit 1999 pjesa e madhe e popullsisë shqiptare u kthye në Prizren.

Literatura:

1. John V.A. Fine, Jr., *The Early Medieval Balkans, dhe 2. The Late Medieval Balkans* (botim Ann Arbor, The University of Michigan Press) 1997.
 3. Noel Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër, Koha, Prishtinë 1998*
 4. Skënder Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI, XVII, Prishtinë 1982*
 5. Jahja Drançolli, *Raguzanët në Kosovë, Instituti i Historisë, Prishtinë 1986, etj.*
- Përpiloi: Prof. Dr. Jahja Drançolli, historian



Kalaja në fillim të shekullit 20-të
Kalaja in the beginning of the 20th Century



Kalaja, 2006

HISTORY OF PRIZREN

In the second half of the 14th century, the town became weakened as a result of conflicts and political divisions. At that time, after the death of the Emperor Dushan (in 1355), the town was ruled by the Serb King Vukashin (1360-1371), and later, after the death of Vukashin in 1371, Prizren was ruled by an Arberor Prince from the Balshaj and Kastriot families. In Prizren and its surroundings during the whole medieval period, well-known monuments of the Roman-Catholic rite were erected (*Sancta Maria de Prisren* and *Sanctus Petrus supra Prisren*)), as were monuments of the Byzantine and Serb Orthodox rites (Church of the Holy Virgin - Bogorodica Ljeviška, and the Monastery of Saint Michael and Saint Gabriel - Sveti Arhandjel near Prizren.)

It is possible that Prizren fell a few times under the Ottomans, however it was in 1459, that the town finally came under the administration of the Ottoman Empire and it prospered again. In the 16th century, the marvellous Ottoman monuments of the Mosque of Gazi Mehmet Pasha, the Hamam of Gazi Mehmet Pasha, and the Mosque of Sinan Pasha were built. At that time, Prizren became part of the Ottoman province of Rumelia. It became distinguished as a prosperous market town, profiting from its geographical position and the North-South and East-West trade routes that connected it effectively with the whole Ottoman Empire. Prizren became the biggest town of the Ottoman administration in Kosovo. The town was conquered once more at the end of the 17th century by the Austrians and their allied forces. However the Ottomans very quickly took it under control again.

Prizren was the cultural and intellectual centre of Kosovo during the Ottoman period. It was dominated by its Moslem population, which constituted over 70% of its population in the year 1857. In 1878 at the time of the League of Prizren the town became the greatest cultural centre of Albanians and the key town coordinating Albanian politics and culture, not only in Kosovo.

In the 20th century, the town experienced an intensive period of rapid changes especially in the market areas. Towards the end of 1918 when the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes was formed, Prizren was re-conquered and became part of the recently formed Kingdom which after 1929 became called the Kingdom of Yugoslavia. Some decades after the installation of brutal Serb governance in Prizren, the town in a word became one of the centers of Albanian nationalism in the struggle for independence.

Prizren and its surroundings were affected very seriously by the war in Kosovo during the years 1998-1999. After the conclusion of the war in June 1999 the greater part of the Albanian population returned to Prizren.

Literature:

1. John V.A. Fine, Jr., *The Early Medieval Balkans, dhe 2. The Late Medieval Balkans* (Published Ann Arbor, The University of Michigan Press) 1997.
3. Noel Malcolm, *Kosovo, A Short History, Koha, Prishtina* 1998
4. Skënder Rizaj, *Kosova during the 15th, 16th and 17th centuries, Prishtina* 1982
5. Jahja Drançolli, *Ragusans in Kosovo, Institute of History, Prishtina* 1986, etc.

Compiled by:

Prof. Dr. Jahja Drançolli, historian


KARAKTERISTIKAT E POPULLSISË SË KOSOVËS DHE PRIZRENIT

Numri i popullsisë së Kosovës, përafërsisht është vlerësuar në 1.8 deri në 2.0 milion banorë. Vlerësimi më i saktë duhet të jetë rreth 1.9 milion. Duke u bazuar në Analizat e Standardeve të Vlerësimit të Jetesës në vitin 2000, 88% janë Shqiptarë të Kosovës, popullsia Serbe është llogaritur në 7% përderisa grupet tjera etnike përbëjnë përafërsisht 5% të totalit të popullsisë. Grupet tjera etnike duke u bazuar në ASVJ kryesisht janë Mysliman/Boshnjak (1.9%), Romët (1.7%), dhe Turqit (1%).

Qyteti i Prizrenit është kryeqyteti administrativ i Komunës së Prizrenit, që ka përafërsisht popullatë prej 222,000 banorëve, përfshirë këtu qytetin dhe 76 fshatra që i përkasin komunës. Pas konfliktit të vitit 1999 përafërsisht 40,000 persona të zhvendosur brenda (PZHB) janë shpërndarë në rajon. Sidoqoftë, rekonstruimi i suksesshëm i më shumë se 10,000 shtëpive krijoi kushte që shumica të kthehen në shtëpitë e tyre (Analiza e Matjes së Standardit të Jetesës, 2000).

Komuna e Prizrenit ka përafërsisht 90% shqiptar dhe grupe tjera minoritare të boshnjakëve, turqve, rom dhe serbëve. Bazuar në regjistrimin e përgjithshëm të Marsit të vitit 1991 dhe të përpiluar nga Instituti Federativ për Statistika të Jugosllavisë, Komuna e Prizrenit është vlerësuar se ka 175,413 banorë. (Analiza e Matjes së Standardit të Jetesës, 2000).

Shqiptarët, boshnjakët, turqit, romët dhe serbët jetojnë në Prizrenin metropolitan. Edhe pse boshnjakët kosovar janë grupi kryesor minoritar në terma të statistikave, komuniteti turk kosovar është mjaft i mirënjohur dhe me influencë. Turqishtja flitet me të madhe, gjithashtu edhe në mes të Shqiptarëve të Kosovës. Në pjesën veriore të Prizrenit, në regjionin e Podrimës, jetojnë së bashku Shqiptarët dhe Turqit. Në pjesën lindore të Prizrenit, në regjionin e Podgorës së Prizrenit, jetojnë së bashku Shqiptarët dhe Boshnjakët. Në pjesën juglindore gjendet Lugina e Zhupës e cila kryesisht është e banuar me Boshnjak, dhe pjesërisht me Serbë dhe Shqiptar Kosovar (Analiza e Matjes së Standardit të Jetesës, 2000).



Piramida e popullsisë së Kosovës
Burimi: Analizat Socio-Ekonomike dhe Demografike 1999 (SOK)

The Population Pyramid of Kosovo
Source: Demographic and Socio-economic Survey 1999 (SOK)


POPULATION CHARACTERISTICS OF KOSOVO AND PRIZREN

The resident population, living in Kosovo, is usually estimated as 1.8 to 2.0 million. The best estimate is probably around 1.9 million. According to Living Standard Measurement Survey 2000, 88% were defined as ethnic Kosovo Albanians. The ethnic Serbian population accounted for 7%, while other ethnic groups together accounted for approximately 5% of the total population. Other ethnic groups consist according to LSMS mainly of Muslims/Bosniacs (1.9%), Romans (1.7%), and Turkish (1%).

Prizren City is the administrative capital of the Municipality of Prizreni, which has an estimated population of about 221,000 inhabitants, both in town and in 76 villages which are a part of the municipality. Following the 1999 conflict, approximately 40,000 internally displaced persons (IDPs) were located in the region. However, the successful reconstruction of more than 10,000 houses has allowed the majority to return to their homes (Living Standard Measurement Survey, 2000).

Prizren Municipality has around 90% Albanians and ethnic minority groups of Bosniacs, Turks, Roman and Serbs. Based on the census of March 1991 completed by the Federative Institution for Statistics of Yugoslavia, the Municipality of Prizren was estimated to have 175,413 inhabitants. In Kosovo census of 1991 is not done (Living Standard Measurement Survey, 2000).

Procesi i hartimit të Planit të Konservimit dhe i Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit filloi më 2005 dhe ajo zyrtarisht u aprovua në 2009 si Plan Rregullues Urban për qendrën historike të Prizrenit. Ky është një nga dokumentet më të rëndësishme të prodhuar deri sot për zonën historike të Prizrenit dhe paraqet një nga dokumentet e vetme referuese të cilën e përdorë QRTKPz në trajtimin e rasteve të ndryshme në punën e saj të përditshme për zonën historike. Ky dokument ofron detaje të veçanta të trajtimit arkitektonik, detaje të cilat kanë munguar në planet e mëparshme. Edhe pse zyrtarisht Plani i Konservimit është aprovuar si Plan Rregullues Urban, si dokument ka më shumë trajtime sesa një Plan Rregullues Urban tipik që kërkohet me ligj. Mirëpo, duke i njohur specifikat e një zone historike, kjo nuk do të thotë që plani ekzistues i aprovuar nuk ka hapësirë për revidim apo edhe plotësim e përditësim të të dhënave, si p.sh: plani i ndarë në nënzonat (I, II, III...) ka nevojë për detajizim edhe më të madh sepse në shumicën e rasteve është i përgjithësuar duke krijuar paqartësi rreth asaj se cilat objekte duhet të ruhen e cilat jo; krijon paqartësi sidomos në terrene të pjerrëta apo edhe në ato pranë monumenteve; të dhënat e marra për gjendjen e objekteve në përgjithësi nuk janë të njejta sepse ato janë të dhëna të para 4-5 viteve, si shkak i ndryshimit të gjendjes prej kohës së miratimit të planit; plane detaje për trajtimin e rrugëve si dhe detaje të trajtimit të mobilitetit urban për një zonë specifike si kjo, etj. Edhe pse plani ekzistues i konservimit nuk ka një mandat të tillë, në të ardhmen do të ishte e udhës të definohej një strukturë menaxhuese që do të ketë kontroll të përditshëm mbi gjendjen e zonës historike, strukturë e cila do të kishte përfaqësim të nivelit qendror dhe lokal. Mosfunksionimi i inspektoratit të ndërtimit nga niveli komunal, dhe në veçanti mungesa e inspektorëve të trashëgimisë kulturore (nga niveli qendror) sot paraqet një nga hallkat më kritike të mosfunksionimit dhe mosrespektimit të rregullave të mbrojtjes së zonës historike të Prizrenit. Vlera e Planit të Konservimit, edhe pse është një nga punimet më të mira që institucioni ynë ka pasur deri më tani, po bie si shkak i mosrespektimit të lejeve gjatë punimeve ekzistuese.

Si përfundim: Sot, mbrojtja e zonës historike më shumë na paraqitet si sfidë e zbatimit të ligjeve të aplikueshme sesa i zbatimit të planeve urbane edhe pse edhe këto plane pas aprovimit zyrtar në nivel komunal, paraqesin poashtu ligj të aplikueshëm për institucionet dhe qytetarët e vendit.

Jusuf Xhibo, inxh.dip.ark.

Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Prizren

Dhjetor, 2011

document contained ample information about the zone, especially for listed monuments however, it did not contain details regarding the treatment of structures around them since as a General Plan it does not address details at such level. It gets more disturbing when the standards or technical requirements set by IPMPz are not followed, or exceeded in most cases, which unfortunately continues to this day.

Process of drafting the Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren began in 2005 and it was officially adopted in 2009 as Urban Regulatory Plan for the Historic Zone of Prizren. This is one of the most principal documents produced to date for Prizren Historic Zone and represents the only reference document which RCHC in Prizren employs when dealing with various cases in its daily work. This document provides specific details of architectural handling, details that have been missing in previous plans. Although the Conservation Plan was formally approved as Urban Regulatory Plan, as a document has more approaches than the standard Urban Regulatory Plan required by law. However, knowing the essentials of the historic zone, this doesn't necessarily mean that the existing approved plan has no room for revision or add-on of data and the updates, as example: the plan for sub-zones (I, II, III...) needs further specification since, in most cases, it is general thus creating confusion over which structures should be preserved and which not; creates ambiguity, especially for the ones in steep terrains or the ones close to monuments; the data obtained for the state of structures, in general, are not the same – given the fact that those inputs were obtained 4 - 5 years ago – due to a change of their state from the time of plan's approval; detailed plans for dealing with the streets and details for the treatment of street furniture for a specific zone as this one, etc. Although the existing Conservation Plan has no such authorization, it would be appropriate in future to define a managing structure that would have a daily control over the state of historical zone – a structure which would represent the central and local level. The standstill of the construction inspectorate in municipal level and, in particular, the lack of cultural heritage inspectors (from the central level), portrays one of the most critical links in the failure and disregard of regulations for the protection of the historic zone of Prizren. The value of the Conservation Plan; although as one of the best works of our institution so far; is declining due to the non-compliance with the existing permits during construction works.

To conclude: In our day, issue of the protection of the historic zone emerges as the challenge of enforcement of applicable laws rather than the implementation of urban plans; although, following formal approval at the municipal level, these plans also establish applicable legislation for the country's institutions and the citizens.

*Jusuf Xhibo, BSc Arch. (graduate engineer of architecture)
Regional Cultural Heritage Center in Prizren
December, 2011*

PLANI RREGULLUES URBAN PËR ZONËN HISTORIKE TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI UDHËRRËFYES PËR ZHVILLIMIN LOKAL TË QYTETIT

Zona Historike e qytetit të Prizrenit prezanton vlerat materiale dhe ndërtimore të këtij qyteti, të ruajtura dhe të trashëguara shekuj me radhë, e formuar nga një numër i madh i objekteve me vlera, monumenteve, rrugëve karakteristike, urave, lagjeve, shesheve, hapësirave përreth monumenteve, lokacioneve arkeologjike, etj. Kjo strukturë urbane me rëndësi historike vlen të trajtohet në mënyrë të veçante dhe të ruhet.

Bazuar në të gjitha këto, Plani zhvillimor Urban 2004-2013 Zonën Historike të Prizrenit e definojnë me kufijtë e saj si zonë e parë e mbrojtur, ndërkaq në literatura të ndryshme e hasim edhe si qendra historike e qytetit të Prizrenit apo zona historike e qytetit të Prizrenit. Megjithatë, kjo është një zonë e përbërë nga një numër i madh i vlerave historike kulturore që e karakterizojnë një zonë të vjetër urbane dhe arkitektonike dhe që duhet pasur trajtim të veçantë përmes hartimit të normativave dhe kriterëve të veçanta.

Në muajin maj të vitit 2006 Kuvendi Komunal i Prizrenit së bashku me Cultural Heritage without Borders (Trashëgimia Kulturore pa Kufij) nënshkruan “Memorandumin e Mirëkuptimit për Implementimin e Programit të Rehabilitimit të Zonës Historike të Prizrenit”, program ky i cili do t'i përfshijë të gjitha komponentet rreth mbrojtjes dhe zhvillimit të zonës historike, bazuar në kufijtë e Planit Zhvillimor Urban – të ashtuquajtur Zona e Parë e Mbrojtur.

Me miratimin e “Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit”, në vitin 2009 si Plan Rregullues (i nxjerrë për të krijuar bazë ligjore e të bazuar në ligjin e Planifikimit me të cilin definohet si 'Plan Rregullativ') hollësisht i përcaktuar; Komuna e Prizrenit, në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren, bazohet në rregulloret dhe kriteret që dalin nga ky plan për trajtimin e kësaj zone dhe të objekteve që gjenden në këtë zonë, pa marrë parasysh ndërtimet e reja, apo trajtimin e atyre ekzistuese si objekte me vlera apo të monumenteve.

Ndërtimet e reja në Zonën Historike të Prizrenit janë bazuar në normativat e dizajnit urban dhe kriteret për projektim si dhe nga rekomandimet e dala nga Plani i Konservimit e të cilat janë të prezantuara në detaje për secilën nën-zonë në këtë plan. Duke pasur parasysh që ndërtimi i ri në këtë zonë, apo edhe në të gjithë qytetin, paraqet sfidë të kohës, është tentuar të ndalet dhe të kontrollohet si për nga materiali ndërtimor, etazhiteti, arkitektura e definuar dhe karakteristikat tjera funksionale dhe urbane që dalin të qarta nga ky plan.



Pamje nga qendra historike e Prizrenit, 2009
View from the historic centre of Prizren, 2009

URBAN REGULATORY PLAN FOR THE HISTORIC ZONE OF PRIZREN AS A PATTERN FOR LOCAL DEVELOPEMENT OF THE TOWN


The Historic Zone of Prizren introduces material and construction values of the town, inherited and preserved over centuries, shaped by a great number of valuable objects, monuments, distinctive streets, bridges, neighborhoods, squares, areas revolving the monuments, archaeological sites, etc. Such urban pattern of historic importance is worth of being specially treated and preserved.

Given all these, Urban Development Plan 2004-2013 defines the Historic Zone of Prizren with its boundaries as Protected Zone 1, while in other literature we encounter it as the Historic Centre of the town of Prizren or Historic Zone of Prizren. Nevertheless, this is an area consisting large number of cultural and historical values that portray a long-standing urban and architectural zone and which should receive unique attention through the development of specific regulations and requirements.

In May 2006 Municipality of Prizren together with Cultural Heritage without Borders (CHwB) signed a “Memorandum of Understanding for Implementation of Rehabilitation Programme for the Historic Zone of Prizren”, a programme that shall encompass all components for the protection and development of the historic zone, based on the boundaries set in the Urban Development Plan – the so-called Protected Zone One (1).

By adopting the “Conservation and Development Plan for the Historic Zone of Prizren” in 2009 as a clearly detailed Regulatory Plan (promulgated for setting a legal basis in accordance with the Law on Planning by which it is defined as the 'Regulatory Plan'); Municipality of Prizren, in cooperation with the Institute for Protection of Monuments in Prizren, stands on the rules and regulations drawn from this plan for dealing with this zone and the objects within it, regardless of new constructions; or dealing with the existing ones as buildings of value or monuments.

The new constructions in the Historic Zone of Prizren are based upon the regulations and patterns of urban design, as well as the recommendations drawn from the Conservation Plan, which are specifically itemized for each sub-zone. Given the new constructions in this zone – and throughout the town – present the challenge of this era, attempts for termination and tracking were undertaken as for the construction material, leveling, defined architecture and other urban and functional patterns clearly deriving from this plan.



Kufinjtë e Zonës Historike, nga PZHU
Borders of the historic zone, from UDP



Sub-zonat brenda Zonës Historike, PKZHP
Sub-zones inside the historic zone, PCDP

Ndërkaq, sa i përket trajtimit të monumenteve, shtëpive me vlera, ansambleve urb-arkitektonike, rrugëve dhe hapësirave publike, Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe ato joqeveritare ka marrë iniciativë për intervenime të vogla apo të mëdha në këtë zonë, duke i trajtuar ato me te gjitha metodat e trashëgimisë kulturore (restaurimin, revitalizimin, konservimin, etj).

Prioritetet dhe normativat e dala nga ky plan, e të cilat janë të definuara për secilën nënzonë, i kanë ndihmuar Komunës për të marrë iniciativë për ndërtimin apo meremetimin e:

✍ Rrugëve: rruga e Farkatarëve, KK Prizren me bashkëfinancim me UN-HABITAT-in, rruga e Shuaip Pashë Spahiut, rruga në Panteli, intervenime në rrugë dhe trotuare në këtë zonë, etj.

✍ Urave: Ura e Marashit, Ura e Lidhjes, etj.

✍ Monumenteve: xhamia e Sinan Pashës, Hamami i Gazi Mehmet Pashes, Kisha e Shën Gjergjit, etj.

✍ Shesheve: sheshi i Deshmorëve, sheshi i Lidhjes, etj.

✍ Objekteve me vlera: shtëpia e Shuaip Pashe Spahiut, shtëpia e Musa Shehzades, intervenime tjera në objekte të ndryshme.

✍ Objekteve Publike: ndërtimi i Art Qendrës, riparime në shkollën fillore Lidhja e Prizrenit – ndërtimi i murit rrethues, ndërtimi i Muzeut të Nënës Tereze, etj.

Bazuar në Planin e Konservimit dhe të Zhvillimit të Zonës Historike, KK i Prizrenit ka krijuar një strategji për hartimin e planeve të detajizuara nga të cilat pastaj do të dalin projekt propozime për Zonën e Nënkalasë, apo edhe të zonave tjera, duke përfshirë edhe buxhetin në mënyrë që si institucion ta ketë të gatshëm pasi që për zonën historike apo nënzonat e ndara nga ky plan janë të interesuar shume investitorë apo që vet Komuna e Prizrenit të jetë e përgatitur për tërheqjen e donacioneve nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare apo edhe nga investitorë privat.

Lidhur me këtë vlen të theksohet që KK i Prizrenit ndien nevojën për plane të detajizuara të këtij lloji si dhe projekt-propozime duke pasur parasysh që një ndër komponentet kryesore për zhvillim ekonomik të Komunës së Prizrenit është edhe turizmi dhe zhvillimi i tij duke e shfrytëzuar trashëgiminë kulturore dhe revitalizimin e objekteve me vlera, monumenteve, shesheve, krijimin e ansambleve me vlera si dhe revitalizimin e atyre ekzistuese si dhe aktiviteteve kulturore që mund të zhvillohen duke pasur parasysh karakterin e zonës.

KK i Prizrenit, në bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe joqeveritare, ka planifikuar organizimin e një punëtorie për përgatitjen e këtyre projekt-propozimeve, konferenca për donatorë, në mënyrë që t'u hap rrugë investimeve në këto zona, por paraprakisht duhet të përgatiten Planet e hollësishme të këtyre zonave në mënyrë që të dalim me projekte konkrete.

Shpresa Osmanollaj, inxh.dip.ark.

Drejtorja e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Prizrenit

Dhjetor 2011



Rruga "Farkatarët" pas përfundimit të projektit, 2011
"Farkatarët" street after the completion of the project, 2011



Pamje nga sheshi i Lidhjes, 2011
View from square of Lidhja (the League), 2011

Meanwhile, as for the treatment of monuments, houses of value, urban-architectural ensembles, streets and public spaces, Municipality of Prizren in cooperation with governmental and nongovernmental organizations have taken the initiative for minor or/and major interventions in this zone, treating them with all the techniques known to cultural heritage (restoration, rehabilitation, conservation, etc.).

Priorities and regulations stemming from this plan, and which are defined for each sub-zone, have aided the municipality in taking the initiative for the construction or rehabilitation of:

✍ Streets: Farkatarëve Street (Prizren Municipality with UN-HABITAT's co-funding), Shuaip Pashë Spahiu Street, the street to Panteli/Pantelija quarter, interventions on the streets and sidewalks of this zone, etc.

✍ Bridges: the bridge of Marash, the bridge of Lidhja (League), etc.

✍ Monuments: Sinan Pasha's Mosque, Gazi Mehmet Pasha's Hammam, St. George Church, etc.

✍ Squares: Dëshmorëve (Martyrs') square, square of Lidhja (the League), etc.

✍ Objects of value: Shuaip Pashë Spahiu's house, Musa Shehzade's house, other interventions in different objects.

✍ Public facilities: construction of Art Centre, repair works in Lidhja e Prizrenit elementary school – construction of the perimeter wall, construction of Mother Teresa Museum, etc.

Based on the Conservation and Development Plan of the Historic Zone, Prizren Municipality has established a strategy for drafting detailed plans of which the project proposals for the zone of Nënkalaja/Potkalaja, or other zones, would emerge; including the budget, due to investors' interest for the historic zone, or the sub-zones outlined in this plan, and so as for Prizren Municipality for getting geared-up for attracting donations from governmental and non-governmental organizations or of private investors.

Regarding this, it is worth noting that Prizren Municipality feels the must for detailed plans of this type as well as project proposals, considering that one of the key components for economic development of Prizren Municipality is tourism and its development by utilizing cultural heritage and revitalization of objects of value, monuments, squares, constructing ensembles of values and revitalization of existing ones, as well as cultural activities that could be developed considering the character of the zone.

In cooperation with governmental and non-governmental organizations Municipality of Prizren has planned to organize a workshop for drawing up such draft proposals, a donors' conference, for paving the way for investments in the mentioned zones, but the need for early preparation of detailed plans for these zones is a must in order to come up with tangible projects.

Shpresa Osmanollaj, BSc Arch.

Department of Urbanism and Spatial Planning, Prizren Municipality

December, 2011



Art Qendra, 2011
Art Centre, 2011



Rekonstruimi i shtëpisë së Shuaip Pashës, 2011
Reconstruction of Shuaip Pasha house, 2011

ZBATIMI I PLANEVE NË VEPRIM

UN HABITAT-i në Komunën e Prizrenit është i angazhuar përmes Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal. Komuna e Prizrenit, në kuadër të fazës së dytë të këtij programi (PMPHK2), ka kërkuar mbështetjen e UN HABITAT-it për zbatimin e Planit për Konservim dhe Zhvillim. Kjo kërkesë ka rënë në përputhje me dy nga objektivat për zbatim të programit të PMPHK2:

Konsolidim i proceseve të planifikimit hapësinor strategjik komunal/urban, gjithëpërfshirës, të orientuar në veprim, që iu përgjigjen nevojave të meshkujve dhe femrave; dhe me spektër të gjerë të instrumenteve për planifikim të aplikuara përmes fuqizimit të kapaciteteve, qasjes në planifikim ciklik dhe në struktura efikase institucionale.

Projekte strategjike kapitale që burojnë nga një proces i planifikimit i zhvilluar dhe i implementuar me pjesëmarrje të barabartë gjinore.

Duke u mbështetur në këto parime janë zhvilluar dy projekte bashkë me Komunën: Udhëzimet për Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit dhe Projekti i Investimit Kapital në rrugën e Farkatarëve.

1. UDHËZIMET PËR ZHVILLIM TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Ky dokument është emëruar Udhëzimet për Zhvillim të Zonës Historike në Prizren. Plani ekzistues i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit është një nga hapat e parë konkret drejt planifikimit për mbrojtjen e secilës hapësirë historike në Kosovë. Ky dokument synon hapa të mëtutjeshëm duke i shtuar këtij Plani një dokument praktik dhe i cili përmban politikat e bazuara në kriteret dhe udhëzimet për zhvillim, që të dyja gjithëpërfshirëse lidhur me legjislacionin aktual të planifikimit. Ky dokument gjithashtu i mundëson edhe masat e një kontrolli të detajuar të zhvillimit, të nevojshme për t'u siguruar që objektivat e Planit janë përmbushur në një shkallë praktike; për vlerësimin e metodave të planifikimit për një zhvillim të ri, modifikimet në ndërtesat ekzistuese, ndryshimet në përdorim si dhe shkatërrimi i objekteve përbrenda zonës historike të Prizrenit.

Në kuadër të Planit të Konservimit dhe të Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, Zona Historike është ndarë në tetë zona:

1. Zona Tradicionale e Tregut
2. Zona e Bllokut të Ndërtesave të Larta
3. Zona e Shtratit të Lumit
4. Zona e Nënkalasë
5. Zona e Rrugës Tregtare
6. Zona e Përdorimit të Përzier dhe Banimit
7. Zona e Banimit (Organike)
8. Zona e Banimit (në trendet e ndërtimit)

Ky dokument përcakton kriteret e hollësishme për zhvillimin e secilit prej këtyre zonave përmes:

Krijimit të një objekti të përgjithshëm të zhvillimit për secilën zonë

Përcaktimit të udhëzimeve zhvillimore që u përgjigjen, reflektojnë dhe i fuqizojnë objektivat e përcaktuara për secilën zonë. Këto udhëzime përfshijnë karakteristikat e vëllimit, fasadës si dhe detajet dhe dekorimet.

Definimit të udhëzimeve të zhvillimit që u përgjigjen, reflektojnë dhe i fuqizojnë objektivat e përcaktuara e që janë në përputhje për të gjitha zonat. Këto udhëzime mbulojnë karakteristikat e strukturës së qytetit dhe të rrugëve.

Për të përcjellur këtë strukturë, dokumenti siguron që udhëzimet janë në përputhje me secilën zonë përbrenda gjithë Zonës Historike dhe se zhvillimi të jetë në harmoni me veçantitë tradicionale të Prizrenit.

IMPLEMENTATION OF PLANS INTO ACTIONS

UN-HABITAT is engaged in Prizren Municipality through the Municipal Spatial Planning Support Programme. Under the framework of this programme's second phase (MuSSP2), Municipality of Prizren solicited the assistance of UN-HABITAT in implementing the Conservation and Development Plan. This request fell in line with two of the MuSPP2 programme objectives of implementing:

1. Municipal/urban strategic, inclusive, action-oriented, spatial planning processes responding to the needs of men and women consolidated and broad range of planning instruments in use through strengthened capacities, cyclic planning approach, and efficient institutional structures
2. Strategic capital projects resulting from the planning process developed and implemented in the gender-equal participatory manner

Following these principles, two projects were then developed with the Municipality; Prizren Historic Area Development Guidelines and a Capital Investment Project in Farkatarët Road.

1. PRIZREN HISTORIC AREA DEVELOPMENT GUIDELINES

This document is called the Prizren Historic Area Development Guidelines. The existing Prizren Historic Area Conservation and Development Plan is one of the first concrete steps towards planning for the protection of any historic area in Kosovo. This document aims to further these steps, by adding to the Plan a practical document containing criteria based policies and development guidelines, which are both comprehensive and inclusive of all current related planning legislation. This document then provides the detailed development control measures necessary to ensure the objectives of the Plan are met at a practical scale; in assessment of planning applications for new development, alterations of existing buildings, change of use and demolishing of buildings within the Prizren Historic Area.

Within the Prizren Historic Area Conservation and Development Plan, the Historic Area is divided into eight zones:

1. Traditional Market Zone
2. High Building Blocks Zone
3. River Bank Zone
4. Nën/Pod Kalaja Zone
5. Commercial Axe Zone
6. Mixed Use and Housing Zone
7. Housing Zone (Organic)
8. Housing Zone (in Construction Trend)

This document specifies detailed criteria for the development of each of these zones by:

Establishing an overall development objective for each zone

Defining development guidelines that respond to, reflect and reinforce the established objectives for each zone. These guidelines cover Volume, Facade and Detail & Ornamentation Characteristics.

Defining development guidelines that respond to, reflect and reinforce the established objectives that are consistent throughout all zones. These guidelines cover Townscape and Streetscape Characteristics.

In following this structure, the document ensures that guidelines are appropriate to each zone throughout the Historic Area and that development is in keeping with the traditional qualities of Prizren.

Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit është një Plan Rregullues Urban (PRrU) ligjërishi i miratuar i cili mbulon hapësirën e përshkruar si “Zonë Historike e Prizrenit”. PrrU-ja synon të realizojë ruajtjen dhe/apo konservimin e kësaj zone përmes rregullimit të zhvillimeve të ardhmshme. Për t’ia arritur kësaj, PrrU-ja i përcakton gjerësisht objektivat e planifikimit si dhe udhëzimet për ndërtim në këtë zonë. Megjithatë ekzistojnë masa të tjera të nevojshme që në mënyrë të duhur të arrihet konservimi i karakterit unik i Zonës Historike. Ky dokument, prandaj, do të përdoret si instrument shtesë i planifikimit praktik, i cili rrënjësisht i përcakton objektivat e projektimit urban si dhe udhëzimet e zhvillimit për këtë zonë. Objektivat dhe udhëzimet në këtë dokument i përfshijnë dhe hollësisht i përpunojnë ato të përcaktuara më herët në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizreni. Dokumenti gjithashtu ofron kritere gjithpërfshirëse si dhe këshilla rreth ndërtimeve, e që nuk janë përfshirë në Plan, dhe të cilat do të mundësojnë ruajtjen e trashëgimisë, ndërkaq parimet e zhvillimit të përcaktuara në Plan të realizohen në një nivel më praktik.

2. PROJEKTI I INVESTIMIT KAPITAL – Revitalizimi i rrugës së Farkatarëve


Projekti i Investimit Kapital është zhvilluar nga UN HABITAT-i, Zyra në Prizren, së bashku me homologët e tyre nga Komuna. Përmes një procesi pjesëmarrës, ku ishin të angazhuar shumë palë të interesit, është identifikuar rruga e Farkatarëve, që gjendet afër sheshit Shadërvan. Ideja kryesore ishte zgjerimi i vijës së këmbësorëve (shetgut) nga sheshi i Shadërvanit, theksimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore si dhe përmirësimi i hapësirës publike.

Identifikimi i Projektit – Është rënë dakord nga të dyja palët që Projekti i Investimit Kapital (PIK) të zbatohet përbrenda Qendrës Historike të Prizrenit, ashtu si përcaktohet në PKZhZH (shih figurën - kufiri i zonës historike). Pas diskutimeve me Grupet Punuese është rënë gjithashtu dakord që si parim i përgjithshëm, për mbështetjen çfarëdo projekti të investimeve kapitale, të jetë integrimi i bërthamës historike të qendrës së Prizrenit (**Shadërvanit**) me vijat kryesore të lëvizshmërisë rreth qendrës, me qëllim përmirësimin e mjedisit të ndërtuar, strukturës rrugore nëpërmjet dizajnit urban, rregullimin lëvizshmërisë si dhe disa elemente të zhvillimit ekonomik nëpërmjet një pjesëmarrjeje gjithpërfshirëse.

Objektivat e arritura gjatë implementimit të rrugës së Farkatarëve janë si më poshtë:

- Integrimi i Shadërvanit me vijat kyçe të lëvizjes
- Theksimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore
- Përmirësimi i mjedisit të ndërtuar, strukturës rrugore dhe cilësia e jetës nëpërmjet dizajnit urban, rregullimit të lëvizshmërisë si dhe disa elemente të zhvillimit ekonomik
- Gjithpërfshirja në procesin e planifikimit
- Kthimi në veprime konkrete të UDHËZIMEVE PËR ZHVILLIMIN E ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Procesi i identifikimit të projektit të PIK-ut kishte përfshirë shumë palë interesi. Gjatë gjithë këtij procesi rolin kryesor e kishte grupi punues i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Institutit për mbrojtjen e Monumenteve në Prizren, CHwB-së si dhe UN HABITAT-i, si udhëheqës i projektit.



The Prizren Historic Area Conservation and Development Plan is a legally adopted Urban Regulatory Plan (URP), covering the area described as the 'Prizren Historic Area'. The URP aims to achieve the preservation and/or conservation of this area through regulation of future development. In doing so, the URP broadly defines planning objectives and construction guidelines for the area.

However there are further measures required to adequately achieve conservation of the character of the Historic Area. This document is therefore to be used as the supplementary practical planning instrument that thoroughly defines urban design objectives and development guidelines for this area. The objectives and guidelines in this document incorporate and elaborate on those already set out in the Prizren Historic Area Conservation and Development Plan. The document also provides comprehensive criteria and construction advice not covered in the Plan, which will allow the heritage conservation and development principles of the Plan to be realised at a more practical level.

2. CAPITAL INVESTMENT PROJECT – Revitalizing Farkatarëve Road


The Capital Investment project was taken forward by the UN HABITAT Prizren office together with its Municipal counterparts. Through the participatory process where were engaged many stakeholders, it was identified the Farkatareve Road which is near the Shadervan square. The main idea was to extend the walking line from Shadervan square, highlight the cultural heritage monuments and upgrade the public space.

Identification of Project - It was agreed by both parties that the Capital Investment Project (CIP) should implemented within the Historic Centre of Prizren as specified in the CDPHZ (see figure-boundary of the Historic zone). It was also agreed after discussions with the Core Groups that the broad principle to underpin any capital investment project is integrating the historic core of the centre of Prizren (**Shadervan**) with key mobility lines around the centre with a view to improving the built environment, streetscape via urban design, mobility arrangement and some element of economic development in a inclusive participatory manner.

The implementation of Farkatareve road achieved objectives are as follows:

- Integrating Shadervan with the key mobility lines.
- Highlighting of the cultural heritage monuments
- Improving the built environment, street-scape and quality of life via urban design, mobility arrangement, and some element of economic development
- Inclusiveness in Planning Process
- Translation of PRIZREN HISTORIC AREA DEVELOPMENT GUIDELINES into actions

In the process of identification of CIP project has been involved many stakeholders. The main role during all process had a core group consisted from the representative from the Directorate of Public Services, Urbanism and Spatial Planning, Institute for the protection of the Monuments in Prizren, CHwB and UN HABITAT - leader of project.



Gjatë hartimit të projekt propozimit, procesi i konsultimit dhe pjesëmarrjes kanë qenë jetike dhe e kanë fuqizuar propozimin. Siç u përmend edhe më lartë, një gamë e madhe e akterëve, grupeve të interesit, organizatave me bazë komunitare (OBK-të) dhe banorë nga zona e projektit kanë qenë të angazhuar në mënyrë aktive dhe i kanë kontribuar këtij projekti.

Inspektimi (Auditimi) i Zonës, i mbajtur me 15 dhe 18 korrik 2009, ishte një prej hapave të parë drejt identifikimit të projektit të investimeve kapitale (PIK) brenda zonës historike. Një numër i madh i palëve të interesuara morrën pjesë në një shëtitje punuese në zonën historike përmes katër (4) rrugëve, ku dhe i nënvizuan fushat dhe çështjet me interes si dhe hapësirat ku nevojiten përmirësime apo revitalizime.

Të gjeturat gjatë Inspektimit të Zonës ishin me vlerë dhe e njoftuan grupin teknik për hartimin e projekt propozimit d.m.th. identifikimin e projektit dhe të dizajnit. Grupi teknik identifikoi dhe i zhvilloi tri (3) alternativa. Megjithatë, vetëm pas një serie seminaresh teknike është vënë përpara opcioni i preferuar – **rehabilitimi i rrugës së Farkatarëve** – për shkak të ndikimit të saj në qendrën historike të qytetit, si dhe në qytetin në tërësi. Opcioni i preferuar, për sa i përket arsyeshmërisë dhe të vizatimeve të projektit, është diskutuar veç-e-veç me secilën familje dhe biznes të vendosur në rrugën e Farkatarëve, dhe që arriti kulmin me një takim të përbashkët. Takimi ka qenë singertë dhe i hapur ndërkaq banorët kanë ngritur disa çështje të vogla në lidhje me detajet e propozimit. Propozimi u mirëprit nga të gjithë dhe u **miratua njëzëri**.

Pas takimit me banorë është mbledhur grupi teknik me ç'rast janë shqyrtuar brengat e paraqitura nga banorët dhe për këtë arsye janë aplikuar disa ndryshime të vogla. Ky propozim iu prezantua edhe OBK-ve tjera, që do të thotë artistëve vendas, DOKUFEST-it dhe të tjerëve, ku dhe të gjithë e kanë mirëpritur dhe miratuar këtë propozim.

Të dyja palët, si Komuna ashtu dhe UN-HABITAT-i, kanë vendosur që në frymën çiltërsisë e të transparencës t'i ftojnë përsëri të gjithë pjesëmarrësit që kanë marrë pjesë në punëtorinë e Auditimit të Zonës. Punëtorja e të gjeturave të Auditimit të Zonës u mbajt me 15 shtator 2009, dhe gjetjet nga ky Auditim i Zonës iu paraqitën pjesëmarrësve, së bashku me projekt propozimin. Prezantimi shkoi dhe më tej për t'i lidhur gjetjet nga auditimi dhe projekt propozimi duke iu demonstruar atyre se në ç'mënyrë komentet, çështjet dhe shqetësimet e tyre, gjatë Auditimit të Zonës, janë kthyer në objektiva të projektit dhe të projektimit. Pjesëmarrësit u ftuan për të komentuar propozimin e të cilat u mblodhën dhe u shqyrtuan. Në fund të kësaj punëtorie pjesëmarrësit e përshëndetën këtë projekt. Zbatimi i projektit do të sjellë atraktivitetin, lidhjen e elementeve kyç të trashëgimisë në qendrën historike si dhe do të përmirësojë lëvizjen e këmbësorëve, dukshmërinë, të rrisë ndriçueshmërinë dhe përmirësimin e trotuareve.

Pas konsultimeve të hollësishme me qytetarë, përmes Auditimit të Zonës, është përzgjedhur "**Rruga e Farkatarëve**" si zonë e projektit. Megjithatë, edhe një pjesë e **rrugës së Saraçëve** do të përfshihet në hapësirën e projektit dhe, për qëllim të këtij projekti, kjo pjesë do të quhet si Rruga e Farkatarëve. Kjo rrugë është në kuadër të Zonës Historike siç theksohet në PKZhZH. Kjo rrugë është pranë sheshit Shadërvan dhe përfshin disa monumente kulture me vlera të mëdha të trashëgimisë, si p.sh. Hamamin e Gazi Mehmet Pashës, Teqenë e Halvetive (Saraçhanës) dhe Shtëpinë e Kulturës (teatri dhe biblioteka publike); si dhe kinemanë e hapur për Dokufest-in, ngjarja më e njohur kulturore në këtë qytet.



In developing the Project Proposal, the consultation and participatory process was vital and underpinned the proposal. As mentioned above a range of stakeholders, interest groups, community based organisations (CBOs) and residents from the project area have been actively engaged and contributed to the project.

Area Audit, held on 15th and 18th of July, 2009, was one of the initial steps towards the identification of the capital investment project (CIP) within the historic zone. A range of stakeholders took part in a transactional walk of the historic zone via four (4) routes and highlighted areas and issues of concern and areas that needed improvement or revitalise.

The findings from the Area Audit were valuable and informed the technical group in developing the project proposal i.e. project identification and design. The technical group identified and developed three (3) options. However only after series of technical workshops a preferred option was put forward – **Revitalizing of Farkatarëve street** - due to its impact to the historic centre and the city as whole. As a first step, the preferred option in terms of the rational and design drawings was discussed individually with each household and business along Farkatarëve street which culminated to a resident meeting. The meeting was candid and open and resident raised some minor issues with regards to the details of the proposal. The proposal was welcomed all and **unanimously endorsed the proposal**.

After the resident meeting the technical group convenes to review the concerns put forward by the resident and some minor modifications were applied to the design. The proposal was also presented to other CBO i.e. the local artists, DOKUFEST and other and all welcomed and endorsed the proposal.

In the spirit of openness and transparency, it was decided by both the Municipality and UN-HABITAT to invite back all the participants that took part in the Area Audit to a workshop. The Area Audit findings workshop was held on the 15th September 2009 and the finding from the Area Audit was presented to the participants as well as the project proposal. The presentation also went further to link the finding from the audit and project proposal by demonstrating to them how their comments, issues and concerns from the Area Audit have been translated into the project objective and design. Participants welcomed to provide comments on the proposal and which was collated and considered. As an outcome from the workshop, participants welcomed the project. The implementation of the project will bring attractiveness, link key heritage elements in the historic centre as well as improve pedestrian mobility, visibility, enhance lighting and improve pavements.

After in-depth consultations with citizens through an Area Audit "**Farkatarëve**" Street was selected as the project area, however a part of **Sarajeve Street** will be part of the project area and that part will also be referred to as Farkatarëve Street for the purpose of this project; this street is within Historic Zone as highlighted in the CDPHZ. (See figure). This street is close to the Shadervani square and includes some cultural monuments with high heritage values .i.e. Gazi Mehmet Pasha's Bath, Tekke of Halveti, as well as the Cultural House (theatre and public library) and the open air cinema for the Dokufest, the most famous cultural event on this city.



Vendndodhja e hapësirës së projektit
Location of project area



Rruga e Farkatarëve lidhet me teqenë Halveti, kinemanë e hapur (bashqe), shtëpinë e kulturës, xhaminë e Saraçhanes deri tek hamami turk me sheshin e Shadërvanit nëpërmjet Urës së vjetër të Gurit.

Projekti i propozuar do t'i lidhë pikat e trashëgimisë kulturore përbrenda zonës; gjithashtu do t'i përmirësojë hapësirat publike në një kontekst më të përshtatshëm për të siguruar shfrytëzueshmërinë nga të gjithë. Tipari kryesor i projektit është t'u **kthehet rruga këmbësorëve**, të vendosen materiale të **përshtatshme në sipërfaqe** e që do të sigurojë qasje të plotë për të gjithë si dhe t'u sigurojë rrjedhë të pa penguar kalimtarëve ndërmjet rrugës dhe Shadërvanit. Kjo ndërhyrje gjithashtu do të **përmirësojë ndriçimin dhe shenjëzimin** për të lehtësuar kalimin e këmbësorëve – për një përjetim sa më të mirë të Zonës Historike të Prizrenit.

Pas punëve të rehabilitimit në rrugën e Farkatarëve Komuna kishte vendosur ta zgjerojë projektin (të financuar nga pronari i Hotel Theranda) me përmirësime në trotuare rreth kësaj zone e që e bën PIK-un më të plotë dhe që dëshmon ndikimin e fuqishëm që ka pasur në Prizren. Është e rëndësishme të theksohet se PIK-u ishte marrë si MODEL gjatë punimeve të këtij projekti, ku materiali i përdorur ishte i njëjtë sikurse ai i përdorur në rrugën e Farkatarëve si dhe parkingu është larguar. Një tjetër rast ndodhet në rrugën përballë, ku shtresa e rrugës nga betoni u hoq tërësisht dhe u shtrua me kalldrëm (kubëza). Është e rëndësishme të theksohet që ky projekt tregoi qartë rëndësinë e qasjes pjesëmarrëse ku komuniteti e zhvilloi ndjenjën e “pronësisë” si dhe ndikimin e tij në tërë zonën historike.

*UN-HABITAT zyra në Prizren
Dhjetor, 2011*



Zbatimi i projektit

Farkatarëve Street connects to the Tekke Havleti, open air Cinema, Cultural House, Saraqhane mosque to the Turkish bath with Shadervan square through the old stone bridge.

The propose project will connect the heritage items within the area; it will also upgrade the public spaces at an appropriate context to ensure usability by all. The main feature of the project is to **pedestrians the street**, introduce **appropriate surface materials** that will provide full accessibility to all, and ensure unimpaired pedestrians flow between the street and Shadervan. The intervention will also **improve lighting and signage** to direct the pedestrian flow, to better experience the Historic Zone of Prizren.

After the improvements in Farkatareve Road, Municipality decided to extend the project (funded by Theranda-hotel owner) with improvements in pavement around this zone which makes CIP more complete and indicates the strong impact in the Prizren. It is important to notice that CIP was taken as MODEL during the design of this project, where used material is same like in Farkatareve road and parking is removed as well. Another case is in opposite road where the concrete pavement of road was removed and paved with cobble stones.

It is important to stress that this project demonstrated the importance of participatory approach where the community developed the sense of the “ownership” and impact in whole Historic Zone.

*UN-HABITAT Prizren Office
December, 2011*



Implementation of the project

Ekipi realizues i publikimit / Publication Team

Botues / Publisher: CHWB - Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Kosovë / CHWB - Cultural Heritage without Borders, Kosovo office

Titulli / Title: **Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit, Kosovë,** Përparësitë dhe sfidat e implementimit/ **Conservation and Development Plan for the historic zone of Prizren, Kosovo,** Advantages and challenges of implementation

Financuar nga / Financed by: Sida - Agjensioni suedez për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar / Swedish International Development Cooperation Agency

Koordinator i publikimit/ Publication coordinator: Enes Toska

Dizajni i publikimit / Publication design: Nora Arapi Krasniqi

Përkthimi/ Translation: Enes Toska, Nol Binakaj, Jeta Limani, Senat Haliti, Nora Arapi Krasniqi (faqet/ pages 8-161), Agron Krapi (faqet/ pages 6-7, 162-177)

Tekstet / Texts: Të gjitha tekstet e paraqitura i atribuohen vetë autorëve të paraqitur në publikim / All texts presented are attributed to the authors themselves presented in publication

Fotografitë dhe hartat / Images and drawings: Të gjithë fotografitë dhe hartat e përdorura në këtë publikim janë pronë e të gjithë institucioneve bartëse, autorëve dhe të pjesëmarrësve të projekteve të paraqitura / All images and maps used in this publication are the property of all implementing institutions, authors and participants of the projects

Ballina / Front cover: Kollazh i dyerve dhe dritareve karakteristike të Prizrenit / Collage of typical Prizren doors and windows, fotografitë nga/ images by Nora Arapi Krasniqi dhe/ and Marina Pelfini


Shtypur / Printed: Dhjetor/ December 2011

Tirazhi / Circulation: 1000

Vizitoni web faqen tonë www.chwbkosovo.org për përditësimin e aktiviteteve tona të fundit ose shkarkoni publikimet tona të listuara më poshtë:

Posetite našu veb stranicu www.chwbkosovo.org za ažuriranje naše poslednje aktivnosti ili preuzeti naše publikacije prikazano u nastavku :

Visit our web page www.chwbkosovo.org for the update of our last activities or download our publications as listed below:





The CHwB projects are mainly financed by
Swedish International Development Agency



Cultural Heritage without Borders, Sweden / Kosovo office

address: Payton City Str. R. Zogovic, 8

10000 Prishtina, Kosovo

office phone: +381 (0)38 243 918

office fax: +381 (0)38 754 866

e-mail: kosovo@chwb.org

web: www.chwb.org